



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e tridhjetë e gjashtë e rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **28.03.2025**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------------|------------------------------------|
| 1. <u>Enver Rugova, LDK;</u> | 13. <u>Fjolla Ukaj, AAK;</u> |
| 2. <u>Hajrush Shoshi, LDK;</u> | 14. <u>Negjdet Ramaj, AAK;</u> |
| 3. <u>Haki Podrimaj, LDK;</u> | 15. <u>Nexhmedin Balaj AAK;</u> |
| 4. <u>Faik Alushaj, LDK;</u> | 16. <u>Niman Beqiraj, VV;</u> |
| 5. <u>Arta Balaj, LDK;</u> | 17. <u>Floriana Maxharraj, VV;</u> |
| 6. <u>Liridona Lajçi, LDK;</u> | 18. <u>Lavdiqe Bujupaj, VV;</u> |
| 7. <u>Valbona Demaj, LDK;</u> | 19. <u>Arian Shatri VV;</u> |
| 8. <u>Ruzhdi Metaj, LDK;</u> | 20. <u>Andi Xhuraj PDK ;</u> |
| 9. <u>Arianit Selmanaj LDK;</u> | 21. <u>Visar Haxhiqaj, PDK;</u> |
| 10. <u>Agron Gashi, AAK;</u> | 22. <u>Era Visoqi, PDK;</u> |
| 11. <u>Ajshe Metaj, AAK;</u> | 23. <u>Djula Karisik, GIBI;</u> |
| 12. <u>Ardita Idrizaj, AAK;</u> | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm Kryetari i komunës Ilir Ferati, NënKryetari i Komunës Ali Nimanaj Drejtorët e Drejtorive, zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV – Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: “shembulli 1”)

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-te e xhirimit gjenden në dosje: “shembulli 2”).

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe publikuar drejtpërdrejt në

<https://www.youtube.com/watch?v=uYFIX-pEwGQ>

<https://www.youtube.com/watch?v=UGFolIYwnnw> “shembulli 3”).

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Kryesuesi i Kuvendit– përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje.
I hap punimet për mbledhjen e tridhjetë e gjashtë të rregullt të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës në sallë, prezentë janë 23 të anëtarë të Kuvendit.

Vazhdojmë me mbledhjen :

R e n d d i t e

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Financiar për vitin 2024,
4. Formimi i Komisionit për ndarjen e bursave për studentë,
5. Formimi i Komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarje të bursave,
6. Shpallja në diskutim publik e Rregullores për Transparencë Komunale,
7. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit- shfrytëzoi rastin që pasi na e kanë kthyer në rishqyrtim vendimin 00 Nr.48/2024 të datës 28.02.2025 për ndarjen e Pronës Komunale për Ndërmarrjen Publike Qendrore Korporata e Ruajtjes së Energjisë KRE SH.A, propozoj ta futim në rend dite pasi që është bërë një gabim më shumë teknik. Pyes ekzekutivin dhe anëtarët e Kuvendit a kanë diçka rreth rendit të ditës? Fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- unë e kisha propozuar si pikë të rendit të ditës, formimin e komisionit për emërimin e objekteve publike, pasi që premtim kemi pasur prej nëntorit të vitit të kaluar, edhe nëse nuk i kemi emrat, mundemi edhe seancën tjetër t'i propozojmë ,por ta futim si pikë të rendit të ditës e të debatojmë për formimin e këtij komisioni. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Negjdet! Fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Genc Ademaj- unë e kisha pasur një pikë të rendit të ditës me e shtuar, ka të bëjë me Plotësim-Ndryshimin e Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha. Kërkesa ka ardhur pak si ad-hoc nga Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë në bashkëpunim me inspektorin e Veterinarisë që e kemi këtu, pra është që të shtohet një taksë shtesë për arsye se deri me tani nuk ka qenë e definuar qartë se

kush duhët të inkasoj këtë pjesë të taksës, taksa ka të bëjë me kontrollin veterinerë të therjes së kafshëve në territorin e komunës së Istogut. Pra propozimi im është të futet te drejtorja e Inspeksionit si taksa e re. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- a ka edhe dikush diçka rreth rendit të ditës? Fjalën e ka Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- drejtor te kjo puna e therjes a hyn tarifa në të gjitha therjet apo vetëm në thertore?

Genc Ademaj- taksa ka të bëjë vetëm për therjet në thertore të licencuara.

Kryesuesi i Kuvendit- pasi nuk ka propozime të tjera rreth rendit të ditës i hedh në votim propozimet e dhëna një nga një. Hedh në votim propozimin e parashtruar nga unë, 'Rishqyrtimin e Vendimit 00 Nr.48/2024 të datës 28.02.2025 për ndarjen e Pronës Komunale për Ndërmarrjen Publike Qendrore Korporata e Ruajtjes së Energjisë KRE SH.A. Kush është të futet në rend dite?

Konstatojmë që nga 22 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 22 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim votohet që kjo pikë të hyn në rendin e ditës së sotme.

Kemi edhe propozimin e Negjdetit, fjalën e ka Andi Xhuraj.

Andi Xhuraj- para dy mbledhjeve unë e kam propozuar pikërisht këtë pikë edhe fatkeqësisht nuk kam marrë mbështetje nga asnjë parti politike. Dhe asnjë parti nuk ka insistuar që pikërisht ky propozim për formimin e komisionit për emërtimet e institucioneve komunale të formohet. Partitë politike kanë heshtur dhe nuk është hedhur as në votim. Kështu që ashtu siç nuk e kanë mbështetur propozimin tim ashtu edhe unë sot nuk kam për t'i mbështetur.

Kryesuesi i Kuvendit- asnjëherë nuk është hedh në votim për me e përkrah LDK-ja ose AAK-ja ose LVV-ja, nuk është hedh në votim ky propozim kurrë. Ai e ka pasur propozim, ju është refuzuar edhe është ndalur me aq. Këta a e mbështetin apo jo u pa, se nuk e kanë mbështetur edhe kur ka qenë atë ditë për emërim të sallës, por ta hedhim në votim, nuk jemi duke marrë vendim menjëherë të emërohet diçka, veç ta formojmë komisionin edhe vazhdojmë tutje.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Haki Podrimaj.

Haki Podrimaj- edhe ne si grup parlamentar i LDK-së sot nuk jemi të përgatitur dhe ne jemi marrë vesh që procedura të fillojë nga ekzekutivi se ne si Kuvend nuk

e kemi atë përgjegjësi në dorë pa na sjellë disa instruksione ekzekutivi. Si ide është e qëlluar por nuk jemi për ditën e sotme, ekzekutivi le të merret me këtë.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- ne kemi të drejtë të propozojmë, me formuar komision, këta kanë të drejtë mos ta votojnë. Kaq.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- Lëvizja Vetëvendosje e mbështet këtë propozim të anëtarit të Kuvendit z. Ramaj për shkak se për neve është e rëndësishme që përveç çështjeve historike edhe çështjet e lokacioneve, emërimi i objekteve, p.sh me e ditë cili objekt në cilin vend është. Kjo nuk është diçka e jashtëzakonshme, thjeshtë është emërim i një komisioni i cili pastaj sigurisht do ta ketë unifikimin dhe votën e anëtarëve të Kuvendit për me e emëruar cilin do objekt apo rrugë. Mendoj që duhet me u mbështetur. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Hajrush Shoshi.

Hajrush Shoshi- mendoj që hapi parë që ishte dashur të bëhej në këtë drejtim është të identifikohen se cilat objekte do të emërohen apo riemërohen nuk mund të formosh komision pa e ditur për çfarë. Çdo objekt që do të emërohet apo riemërohet duhet ta ketë një komision të veçantë. Nuk është ky komision për emërim, e nëse duam ta bëjmë një komision për identifikim se cilat objekte do të emërohen apo riemërohen është diçka e natyrshme, bashkë me ekzekutivin me u ulur dhe me i identifikuar se cilat objekte kanë nevojë të emërohen. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- kjo është mjaft komplekse, jo e lehtë as për kryesuesin as për ne të gjithë këtu ajo se çfarë e propozoi këshilltari Ramaj, ka të drejtë ta propozoj, të gjithë jemi të jetë ajo. Po e jap personalisht një propozim Negjdet jo ty por të gjithëve. Të ja japim detyrë ekzekutivit dhe të përgatiten për mbledhjen e ardhshme, po kam qejf që kjo të bëhet. Po e propozoj këtë nëse pajtohesh nëse jo procedojmë me punë. Fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- ne kemi shumë objekte në Istog që janë të emëruara por nuk janë legalisht. Kështu që me këtë komision kishim mundur që me i legalizuar edhe ata emra që kanë qenë më herët, nuk kemi specifikë vetëm për një objekt por për shumë objekte. Nuk është patjetër ta presim ekzekutivin sepse kemi pritur shumë gjatë, prej nëntorit nuk është marrë asnjë iniciativë, për këtë po them ta formojmë komisionin.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit! Fjalën e ka Nënkryetari i komunës.

Nënkryetari i Komunës- Negjdet po mendoj që është punë realisht e Kuvendit se si të procedoj edhe në të jetë në vullnetin e juaj a doni të procedoni tutje apo jo. Por kisha kërkuar që fillimisht duhet ta kemi një Rregullore, një draft me i përcaktuar kriteret për të gjitha emërimet e institucioneve publike në territorin e komunës tonë, dhe pastaj pas kësaj të aprovohet në Kuvend, del në dëgjim publik, prapë të aprovohet në Kuvend dhe pas formimit të komisionit nga Kuvendi për secilin objekt publik varësisht prej specifikave munden me ardhur deri te emërimet e atyre, nuk ka asgjë të keqe.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Nënkryetar! Fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- kjo çështje nuk është edhe aq e lehtë sepse nuk është hera e parë që është debatuar për riemërime, ka pasur shumë propozime, shumë mospajtime, jam për atë me qenë ajo Rregullore e specifikuar dhe me qenë komisioni i të gjitha subjekteve në mënyrë që mos të ketë anime politike se ne këtu politikë po bëjmë. Jam edhe për atë që u përmend stadiumi i Istogut që e ka emrin "Demush Mavaraj" që është emëruar me një personalitet i cili vërtetë i ka pasur meritat, si sportist edhe si dëshmor. Nuk ma merr menja që këtu me pas nevojë me riemëruar edhe njëherë sepse i ka pasur të plotësuar të gjitha specifikat. Prandaj objektet që i kemi të pa emëruara jam për atë që të formohet një Rregullore të bëhet një përgatitje e mirë dhe vërtetë të shkojnë njerëzit që e meritojnë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- mos te keqkuptojmë atë që e tha Negjdeti, janë të emëruara por nuk janë me vendime dhe mundemi të bëjmë me vendime, Negjdet prapë po të them ta obligojmë ekzekutivin për mbledhjen e ardhshme. Të formohet komisioni për hartimin e Rregullores, nuk mund të marrim vendime ad-hoc Negjdet.

Negjdet Ramaj- ta lexoj vetëm një pjesë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, komuna ose niveli lokal merr vendim për krijimin e një komisioni për emërimin e objekteve publike, ky vendim mund të miratohet nga Kuvendi i Komunës i cili përcakton përbërjen dhe detyrat e komisionit. Nuk mund të merr asnjë vendim ky komision pa e përcaktuar ne. Pastaj ne mund të veprojmë, vijmë propozime të ndryshme, ky komision ka me e shqyrtuar kush, ku do të jetë, dhe prapë do të vijë këtu ta votojmë ne. Edhe ajo që e tha profesoresha Ajshe, asnjëherë nuk e kam thënë atë që riemërohet një stadium por me e legalizuar.

Ajshe Metaj- jemi keqkuptuar.

Kryesuesi i Kuvendit- komisioni Negjdet formohet në bazë të Rregullores. Unë e kam në plan ta hedh në votim propozimin e juaj, por po më vjen keq që po dalim para qytetarëve jo mirë. Fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- po tërhiqem nga ky propozim, por kërkoj nga ekzekutivi që seancën tjetër të vjen me një propozim Rregullorë për emërimin e hapësirave publike por seancën tjetër të vijmë me një draft Rregullorë, t'i japin propozimet e veta secili edhe vazhdojmë tutje.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Nënkryetari i Komunës.

Nënkryetari i Komunës- në rregull është ajo që e diskutuam edhe më herët. Duhet të ketë një Rregullorë, se kur duam të ja vendosim një emër një institucioni publik t'i kemi kriteret e qarta se si duhet veprojmë. Në parim jemi në rregull se duhet të hartohet një akt normativ e pastaj të procedohet tutje.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit të gjithëve për kontributin tuaj. Hedh në votim edhe propozimin e drejtorit Genc Ademaj, për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha? Kush është të futet në rend dite?

Konstatohet që nga 19 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 19 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet propozimi i drejtorit Genc Ademaj, për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha?

Kryesuesi i Kuvendit- e hedh në votim rendin e ditës me propozimet e dhëna. Kush është që të procedojmë me këtë rend dite për mbledhjen e sotme?

Konstatohet që nga 19 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 19 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet rendi i ditës për mbledhjen e sotme.

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit- Në mbledhje mungojnë Faruk Kabashi, Njomza Demaj dhe Florin Dreshaj (të cilët nuk kanë marrë pjesë në mbledhje).

Të pranishëm në mbledhje janë 19 anëtarë të Kuvendit (disa prej tyre kanë lëshuar mbledhjen, disa të tjerë kanë dalë dhe kanë hyrë prapë).

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapi debatin në lidhje me procesverbalin nga mbledhja e kaluar? A ka dikush vërejtje apo sugjerime? Pasi që nuk ka diçka tjetër e hedh në votim kush është që të miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar?

Konstatojmë që nga 19 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 19 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi i Kuvendit-fjalën e ka Nënkryetari i Komunës.

Nënkryetari i Komunës- fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Genc Ademaj- prezanton pikën e rendit të ditës 'Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Financiar për vitin 2024.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor! E hapi debatin rreth kësaj pike. Agron Gashi e ka fjalën.

Agron Gashi- vetëm desha të lidhem me të gjeturat e Raportit të Auditorit të cilat kanë ardhur të përsëritura. Janë disa pika kryesore, si p.sh mos respektimi i hapave për pagesa të ndryshme, subvencionet jo në përputhje me qëllimin e dhënë, mos respektimi ose mos regjistrimi i pasurive komunale që janë nën 1.000 euro dhe keq klasifikimi i shpenzimeve. Desha ta pyes drejtorin a është punuar në këto digastere, a janë monitoruar në mënyrë mos të bëhet prapë i njëjti gabim si më herët, pasi që komuna jonë po penalizohet edhe nga raporti i transparencës edhe nga granti qeveritar.

Genc Ademaj- te mos respektimi i hapave për pagesa është ndërtuar një procedurë e re, që në momentin që operatori e dorëzon faturën e sheh online se në cilën procedurë e ka, ne kemi një afat prej 30 ditësh. Vitin e kaluar arsyeja e vonësës së pagesave në mungesë të fondeve. Tani plani i shpenzimeve bëhet në baza mujore që është një ngarkesë e panevojshme, është rregull financiar që me e parashikuar nuk mundesh por po e aplikojmë por nuk është i mirë. Vazhdon sqarimin më tutje. Te subvencionet ka pasur të bëj me pjesën e ndërmarrjes publike Stacioni i Autobusëve ku ka ndodhur një mos respektim sipas Auditorit që sipas meje nuk mund ti parashikosh të gjitha obligimet që dalin. Realisht kërkesat që i ka pasur atëherë Stacioni i Autobusëve të gjitha janë mbuluar. Dhe te pjesa e keq klasifikimit, ka të bëj me pjesën e kontratës kolektive. Te pjesa e pasurive komunale që janë nën 1.000 euro e kemi punësuar një zyrtar fatmirësisht dhe është duke u marrë vetëm me atë pjesë dhe besoj ka me pasur rezultat pozitiv.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- sa i përket këtij raporti financiar, ne edhe kur është votuar buxheti si LVV kemi qenë kundër për arsyet që i kemi dhënë, tani në bazë të këtij raporti vjetor që e kemi lexuar vetëm sa janë vërtetuar se ka qenë me shumë e fokusuar në dreka dhe darka. Si fakt ka disa fatura që janë ushqim dhe pije që kanë mbetur pa u paguar, sipas këtij raporti në mungesë të fondeve ose për hir të thjeshtësisë, borxh në restaurante. Te

pagat dhe mëditjet e kemi 99.99% që është mirë që është shfrytëzuar krejt, mirëpo kjo tregon fokusin që te shpenzimet kapitale janë diku 84.06% apo afër 700 mijë euro të dërguara në suficit. Për këto edhe për arsyet e tjera që i përmendi edhe Agroni ne votojmë kundër edhe e kishim pasur një kërkesë për ekzekutivin komunal që të hyni borxh për të ngrënë. Faleminderit!

Genc Ademaj- po më vjen keq që duhet të të përgjigjem kështu, edhe ti e ke marrë një pozitë të drejtorit dhe duhet të kesh kujdes kur jep një rekomandim financiar. Nëse i shikon datat e faturave e ke datën 27-të të muajit të 12-të, tregomë cili rregull financiar të lejon në tri ditët e fundit të vitit fiskal të bësh pagesë financiare. E dyta, ka të bëjë te pjesa e projekteve kapitale, po flasim për 15% të mos shpenzimit të projekteve kapitale që është buxheti në total që ishte 95.2% e që është për tu mburrur. Kjo është përgjegjësia e një menaxheri të mirë e që me plot mburrje me të gjithë këta kolegë rrimë para jush. Është rekord, ka qenë vjet, këtë vit. Pjesa tjetër e mos realizimit të buxhetit ka qenë që e kemi lënë peng vet, e kam lënë vet unë për me i përfunduar procedurat përmbartimore të vendimeve gjyqësore mos me i prek pagat e zyrtarëve. Kjo ka qenë arsyeja dhe asnjë zyrtarë nuk ka mbetur pa paga. Përkundër që kur e kemi bërë bartjen ju nuk e keni votuar si Lëvizje Vetëvendosje. Raporti financiar është jashtëzakonisht transparentë dhe profesional, është standard ndërkombëtar nuk e përcaktojmë ne. Nëse ka pasur dreka gjithsecili anëtar i Kuvendit e din si krijohen ato, pardje e kemi pasur një pensionim të një zyrtari ja kemi organizuar një koktej rasti ka kushtuar 250.00 euro ato asnjë prej nesh këtu nuk i kemi ngrënë.

Kryesuesi i Kuvendit- Niman Beqiraj replikë.

Niman Beqiraj- drejtori me tregoj se si nuk duhet me ra në nivel për shkak të pozitës, por në fund ra vet. Këto faturat e 27 dhjetorit janë fatura të ushqimit e morëm vetëm si shembull, e para tani jemi në muajin prill, e dyta nuk e kam parë që është pensionuar dikush me 27 dhjetor ndonjë koktej a diçka. Unë i përmenda në bazë të këtij raporti nuk i kam shpikur këto. Edhe tjetra te shpenzimet kapitale 700 mijë euro të humbura janë pjesë e suficitit janë prej shpenzimeve kapitale. Forma si ka shkuar tregon që fokusi ka qenë në paga dhe mëditje se sa te kjo, është fakt që e keni shpenzuar rekord, por e keni shpenzuar atë që e thashë më herët.

Genc Ademaj- në total prej atyre 700 mijë euro, 144 mijë euro janë nga skema e huamarrjes, nuk është buxhet i komunës, është i ministrisë së Financave. Nuk ka pasur formë, por vet e kam ndërtuar për të gjitha komunat e Kosovës. Te burimi i financimit 10 që kanë shkuar në suficit janë 370 mijë euro që i kemi lënë peng për pagesat e kontratës kolektive. Pra prej asaj 700 mijë reale janë 370 mijë euro. Prej këtyre 370 mijë afër 90 mijë janë minimum teprice e kontratave të kontraktuara. Prej fondit burimor 21 janë 127 mijë euro që i kemi në dispozicion edhe këtë vit, janë të hyra komunale që nuk shkojnë në suficit. Fondi burimor 22 që janë të bartuara nga viti paraprak që janë 88 mijë euro dhe nga fondi burimor 31 që janë donacione dhe participime të qytetarëve me projekte me bashkëfinancim e që janë bartur edhe këtë vit, janë 19 mijë euro dhe fondi burimor 78 që është prej USAID që janë 3 euro e 18 cent. Prej këtyre në total 280 mijë

euro suficit, nuk po them që është shumë e vogël se me pas mundësi çdo shumë e shpenzoj, por e prezantova arsyen pse. Pjesën e kategorisë së pagave ne nuk e kemi as obligim ligjor me e mbuluar, niveli qendror e ka ligjërisht. Vazhdon sqarimin.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- u fol se kemi shumë toka, ne si komunë diku 87 milion euro, shumica e tyre gjinden nëpër fshatra, mirëpo normal kemi edhe në qytet zonën urbane. A inkasojmë ne diçka prej këtyre tokave çka janë në zonën urbane, pasi dihet që në shumicën e këtyre parcelave ka ndërtime të egra, shtëpi banimi ose objekte tjera. Faleminderit!

Genc Ademaj- po ka prona komunale edhe në zonën urbane që janë në shfrytëzim afatshkurtër. Të gjitha ndërtimet që janë në prona publike komplet në territorin e komunës së Istogut të gjitha janë në gjykatë. Ata që kanë uzurpime të vrazhda janë duke u marrë organet kompetente. Ne si komunë e kemi bërë listen në vitin 2017 të të gjitha uzurpimeve dhe i ka marrë prokuroria, deri në një vendim të tyre, ka raste që kemi intervenuar për lirim të pronave, ndërsa për rrënimë të tjera, presim vendim të gjykatës.

Kryesuesi i Kuvendit- pasi që nuk ka diçka tjetër e hedh në votim, kush është të votohet kjo pikë e rendit të ditës?

Konstatojmë që nga 23 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 19 vota pro 4 kundër dhe 0 abstenim miratohet Raporti Financiar për vitin 2024.

Shqyrtimi i pikës 4.

Kryesuesi i Kuvendit- formula është pesë anëtarë, tre nga Kuvendi, nga tri partitë më të mëdha, drejtori i drejtorisë është kryesues i komisionit me automatizëm dhe gjithashtu një nga shoqëria civile që e propozon kryetari. Fjalën e ka Andi Xhuraj. Ju kisha lutur për propozimet e juaja.

Andi Xhuraj- e kam një kërkesë nga partitë politike që si emra për këtë komision ti propozojnë ata që janë përkatës të fushës së arsimit. E jo me pas gabime si herën e kaluar. E të ketë sa më pak ankesa në komisionin tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- unë nuk jam i fushës të arsimit por kam qenë në komision për ndarjen e bursave dhe nuk ka qenë asnjë ankesë e vetme. Nuk ka nevojë të jetë i fushës vetëm e ka për detyrë ta zbatoj Rregulloren.

Andi Xhuraj- unë e pata fjalën për komisionin e parë ku saktë e di që janë 30-37 ankesa që janë bërë. E komisionet që janë formuar pasi janë shkarkuar këta aty nuk ka fjalë kanë qenë fenomenale.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Agron Gashi.

Agron Gashi- në komisionin paraprak është bërë një gabim tek lëndët deficitare i cili ka qenë i viteve të mëhershme dhe aty ka qenë gabimi teknik.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Haki Podrimaj.

Haki Podrimaj- grupi i jonë i LDK-së e propozon si anëtar për komisionin për ndarjen e bursave z. Faik Alushaj.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Agron Gashi.

Agron Gashi- nga AAK-ja propozojmë znj. Fjolla Ukaj.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- ne Lëvizja Vetëvendosje e dërgojmë emrin me email.

Kryesuesi i Kuvendit- në rregull. Fjalën e ka drejtori Naim Behlulaj.

Naim Behlulaj- jep sqarim lidhur me ndarjen e bursave për vitin 2024.

Kryesuesi i Kuvendit- e hedh në votim, kush është të miratohet ky komision?

Konstatohet që nga 23 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 23 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet pika e rendit të ditës formimi i Komisionit për ndarjen e bursave për studentë.

Shqyrtimi i pikës 5.

Kryesuesi i Kuvendit- formula është e njëjtë, tre nga anëtarët e Kuvendit, këtu kemi drejtorin e Administratës nga ekzekutivi dhe një emër e propozon kryetari nga shoqëria civile. Fjalën e ka Haki Podrimaj.

Haki Podrimaj- grupi i jonë i LDK-së e propozon si anëtar për komisionin për ankesa ndaj ndarjes së bursave znj. Liridona Lajçi.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Agron Gashi.

Agron Gashi- nga AAK-ja propozojmë znj. Ardita Idrizaj.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- ne Lëvizja Vetëvendosje e dërgojmë emrin me email.

Kryesuesi i Kuvendit- gjithashtu kryetari i sjellë emrat tjerë. Pasi nuk ka diçka po votojmë? Kush është të miratohet ky komision?

Konstatojmë që nga 23 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 23 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet pika e rendit të ditës Formimi i Komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarje të bursave.

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi i Kuvendit- pasi është për diskutim publik, po i ruajmë diskutimet e mëvonshme kur të vjen prapë në Kuvend për miratim. Kush është për?

Konstatojmë që nga 22 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 22 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet pika e rendit të ditës 'Shpallja në diskutim publik e Rregullores për Transparencë Komunale.

Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi i Kuvendit- e thashë në fillim kur e propozova që të hyj në rend dite që është më shumë gabim teknik dhe plotësues. Fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- ne nuk e kemi problem që është kthyer kjo, por po kthehen shumë, edhe pse është nga ana teknike, zyra ligjore duhet të punoj më shumë. Nëse është teknik kisha pasur dëshirë ta di se çka është ajo anë teknike që kjo nuk ka shkuar në vend.

Kryesuesi i Kuvendit- është përfshirja edhe e një ligji shtesë.

Konstatojmë që nga 19 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 19 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet Rishqyrtimin e vendimin 00 Nr.48/2024 të datës 28.02.2025 për ndarjen e Pronës Komunale për Ndërmarrjen Publike Qendrore Korporata e Ruajtjes së Energjisë KRE SH.A.

Shqyrtimi i pikës 8.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Genc Ademaj- arsyeja e plotësimit të Rregullores ka të bëjë me shtimin e një neni te drejtoria e Inspeksionit. Konkretisht titulli i saj është kontrolla veterinerë dhe therjes së kafshëve në territorin e komunës së Istogut që është 5.00 euro për therje. Sqaron më shumë.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapi debatin. Ajshe Metaj e ka fjalën.

Ajshe Metaj- edhe mandatin e kaluar e kemi diskutuar dhe na ka interesuar shumë inspektimi i ushqimit në thertore, por në atë kohë është thënë që është numri i kufizuar i inspektorëve dhe në atë drejtim nuk është bërë asgjë. Më vjen mirë që është shtuar kjo taksë, nuk e di a ka pasur taksë përpara. Tani mendoj që jemi më të sigurt në ushqim pasi kontrollohen nga inspektorët. Pra taksat bëhen vetëm te thertoret që janë të certifikuara, çka ndodhë me therjet jashtë kësaj dhe sa jemi ne si qytetarë të sigurt për ato ushqime.

Genc Ademaj- te inkasimi i taksës ne e kemi pasur një hendikep ligjor te konkursi lidhur me inspektorin e veterinarisë sepse është kompetencë direkte e AUVK-ut prandaj ne i kemi zhvilluar procedurat me një marrëveshje të bashkëpunimit mes kryetarit dhe AUVK-ut thjeshtë inspektori mos të kaloj në Pejë se këta janë regjional, por të mbetet në komunë. Arsyeja pse është e mirë kjo taksë është për dy elemente, nën një, ja u mundëson thertoreve me aplikuar për subvencione dhe çka është më rëndësi prejardhja e kafshës. Asnjë market në komunë të Istogut nuk mundet të shes mish pa e pasur certifikatën e prejardhjes dhe thertores. Në komunën e Istogut kemi gjithsejtë 9 thertore të licencuara.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- desha ta di a praktikohet nga komunat tjera kjo taksë prej 5.00 eurove, mua po më duket është shumë shkurt për neve me vendos, me ja u vendosur këto taksa thertoreve pa diskutuar me pronarët e thertoreve se kjo mund të implikohet te çmimet e konsumatorëve që i blejnë ato produkte.

Genc Ademaj- nuk është ngarkesë e madhe Negjdet, ne e kemi diskutuar dhe realisht të gjitha therjet që kanë ndodhur tri vitet e fundit ata veç e kanë pranuar pagesën prej 5.00 eurove, problemi ka qenë që a duhet të definohen ato taksa me i marrë AUVK apo komuna e Istogut, ne e kemi pasur këtë vakum ligjor.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Haki Podrimaj.

Haki Podrimaj- dua të ndërlidhem me bisedën e koleges Ajshe, mandatin e kaluar unë e kam kërkuar këtë taksë, vetëm për një arsye me i heq shpenzimet komunale, thertoret kanë qenë të inspektuara edhe më përpara por si komunë nuk e kemi pasur atë të drejtë me e inkasuar këtë taksë.

Kryesuesi i Kuvendit- pasi që nuk ka diçka tjetër, e hedh në votim? Kush është për?

Konstatohet që nga 21 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 21 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet Plotësim Ndryshimi i Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha.

Shqyrtimi i pikës 9.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Hajrush Shoshi.

Hajrush Shoshi- është një objekt në Banjë të Pejës në mes të parkut që kishte me qenë mirë me shku dhe me e inspektuar, ai objekt është i rrethuar, por brenda mundet dita e ditës të rrëzohet dhe me e zënë dikë. Është mirë me e marrë parasysh dhe me e bërë rrënimin e atij objekti.

Genc Ademaj- një sqarim lidhur me objektet e pa shfrytëzuara dhe ato që paraqesin rrezik për qytetarët, policia e Kosovës bashkë me inspektorin e ndërtimit që e kemi e kanë bërë inspektimin e të gjitha objekteve që paraqesin rrezik, e kemi bërë një raport dhe e kemi bërë një kontratë për rrenim. Drejtorja e Inspeksionit është duke punuar që me i obliguar qytetarët me i rrënuar objektet në pronësi të tyre për shkak se është një ngarkesë e jashtëzakonshme për buxhetin e komunës. Thjeshtë ne jemi përgjegjës për pronat që i kemi. Kemi filluar me rrënimin e objekteve që paraqesin rrezik sidomos në zonat urbane. Vazhdon sqarimin.

Kryesuesi i Kuvendit- Hajrush Shoshi e ka fjalën.

Hajrush Shoshi- ajo pronë është e komunitetit serb, është e pa mbrojtur, nuk ka pronar që e kërkon atë, sa i përket shpenzimeve nuk e besoj se duhej të kishte problem që pronari i "Onix" ta heq atë mirëpo duhet një leje. Shkoni shikojeni sa ka siguri.

Genc Ademaj- i kemi dy objekte në qendër që nuk e kemi asnjë mundësi ligjore, është problemi te ligji e jo te vullneti, prona është e shenjtë është një marrëveshje nuk guxon me ja prek asnjë tjegull, pavarësisht sa paraqet rrezik, e me e siguruar është diçka tjetër, por me e rrënuar nuk guxojmë.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Arta Balaj.

Arta Balaj- e kam një pyetje për drejtorin e drejtorisë së Bujqësisë z. Astrit Hajrizaj pasi që është këtu, a ka mundësi drejtor të na sqaroni publikisht se çfarë po ndodhë me kanalin e ujitjes në lagjen "Balaj" në Lluga i cili ka filluar para pesë vitesh dhe vazhdon të mbetet në gjendjen e njëjtë.

Astrit Hajrizaj- me ardhjen time si drejtor e kemi ndërprerë një kontratë që ka mbetur pa u përfunduar projekti dhe kemi vazhduar me procedurat për me u implementuar ai projekt dhe mos me mbetur në atë gjendje për arsye se për veç nevojës që shfrytëzohet për ujitje po ju shkakton problem edhe disa banorëve. Ne edhe në vitin 2023 edhe 2024 e kemi iniciuar si procedurë projektin e ndërtimit të atij kanali, dhe kemi vazhduar me procedurat e prokurimit dhe që dy herë nuk kemi ofertues apo operator të përgjegjshëm për ndërtimin e këtij kanali.

Arta Balaj- e kam një kërkesë për drejtorin e Zhvillimit Ekonomik z. Genc Ademaj, kërkesa është nga fshati Muzhevinë rruga “Jakup Balaj” me gjatësi vetëm 570 metra, a ka mundësi buxhetore që kjo rrugë të shtrohet.

Genc Ademaj- Artë, kanali i ujitjes ka me u realizuar si projekt. Te pjesa e rrugëve në Muzhevinë këtë vit asfaltohen të gjitha rrugët në fshatin Muzhevinë, se nuk janë shumë.

Arta Balaj- gjatë një vizite në shkollën fillore në Llukafë të Begut në takim me drejtoreshën e shkollës znj. Sheqere Gashi mu adresuan dy kërkesa për drejtorin e Arsimit z. Naim Behlulaj, shkolla Fan S. Noli është shkollë që plotëson të gjitha kushtet që duhet të ketë një shkollë por ka dy mungesa, shkolla ka nevojë për karrige dhe banka të reja si për nivelizimin e oborrit të shkollës, sepse vendi kur ka qenë shkolla e vjetër pengon aktivitetet e nxënësve dhe paraqet rrezik shumë të madh për ta.

Naim Behlulaj- vitin 2023-2024 i kemi furnizuar të gjitha shkollat me inventarë në veçanti edhe këtë shkollë. E kemi kontratën me nivelin qendror që drejtoresha e di shumë mirë që mundet me i porositur, buxhetin e ka dhe i vijnë. Ndërsa sa i përket rregullimit të infrastrukturës së jashtme, e kemi rregulluar atë pjesë dhe nuk ju pengon aspak pjesa e aktiviteteve të nxënësve.

Kryesuesi i Kuvendit- Niman Beqiraj e ka fjalën.

Niman Beqiraj- i kam disa pyetje, një prej të cilave është prej disa prindërve të shkollës “Bajram Curri” në Istog ankohen për mungesë të nxemjes dhe ambientit të ftohtë në shkollë. Kjo shfaq frikën që mund të ketë sëmundje tek fëmijët. Kërkesa tjetër është për drejtoreshën e drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, për fushën në Vrellë kjo e reja që është ndërtuar, pra vijat e fushës dhe pjesa tjetër me e përcjellë që me e bërë tamam të gashtme për lojë të vijnë dhe t’i përfundojnë për shkak se i kam parë që po luajnë deri në orët e vona por nuk e kanë asnjë nga vijat ku me u fokusuar. Dhe një pyetje tjetër e kam për investimet në qendër të Vrellës të cilat janë përmendur në buxhetin e këtij viti, kur po fillojnë, këtë pyetje po e bëj për shkak të frikës që mund të kalojnë në suficit. Faleminderit!

Naim Behlulaj- ata prindër që kanë ankesë, duhet me ju drejtuar drejtorisë së shkollës dhe drejtorisë së Arsimit se vetëm muajin e kaluar i kemi blerë edhe 60 metra dru, unë çdo ditë jam në atë shkollë dhe i shoh dritaret e hapura, nëse fëmijët kanë të ftohtë dritaret mbyllën. Sa i përket vijave në fushën në Vrellë është e vërtetë që janë fshirë, por punëkryesi i ka vendosur vijat pas ankesave që i keni bërë, e kemi thirrur punëkryesin edhe njëherë dhe ka premtuar që si të rregullohet koha do të vendosen prapë në atë fushë.

Niman Beqiraj- unë i sjella disa prej kërkesave të prindërve ku me gjasë nuk kanë gjetur përgjigje të duhur. Unë njoh shumë prindër që kanë thënë që është ftohtë. Unë e përcjella si kërkesë që nëse është e vërtetë të trajtohet.

Naim Behlulaj- edhe unë tu përgjigja Niman që sinqerisht nuk është ftohtë. Nëse ka ankesa le të vijnë dhe të drejtohen tek ne.

Kryesuesi i Kuvendit- Liridona Lajçi e ka fjalën.

Liridona Lajçi- desha të ndërlidhem pasi që jam vet prind dhe e kam vajzën në atë shkollë, përkundrazi për shkak të nxehtësisë, ne po kemi kërkesë që fëmija të vishen më komod sepse po e kanë të pamundur sepse është nxehtë. Po më vjen keq se janë një staf i mrekullueshëm.

Andi Xhuraj- dikush po thotë është ftohtë dikush nxehtë, drejtori kohë ka mund të shkoj dhe ta shoh gjendjen dhe me e gjetur një zgjidhje.

Kryesuesi i Kuvendit- Valbone Demaj e ka fjalën.

Valbone Demaj- unë jam duke e bërë një praktikë në atë shkollë dhe nuk mund të rrih prej nxehtësisë. Më vjen keq nëse ata prindër janë keq informuar.

Kryesuesi i Kuvendit- Agon Dreshaj e ka fjalën.

Agon Dreshaj- parku në Vrellë Niman bashkë me shtëpinë e fshatit, projekti kryesor ka përfunduar, dhe po presim iniciimin e procedurave që besoj që fillojnë menjëherë në muajin Prill.

Kryesuesi i Kuvendit- Negjdet Ramaj e ka fjalën.

Negjdet Ramaj- një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike, kur po ndodhë rregullimi apo rrethimi i shkollave, fushave të sportit po bëhet shumë mirë. Kemi raste kur në 2018 janë bërë atë rrethoja, tani ato po prehen dhe po hiqen nga aty, a kanë ndonjë depo që i vendosin ato apo i merr punëkryesi i shet për hekur, çfarë ndodhë me ato rrethojat paraprake, se kam informacion që ato rrethoja përdorën prapë, mundet në çmim me ul.

Naim Behlulaj- faleminderit Negjdet për pyetjen! Rrethojat e shkollave dhe fushave të sportit janë në digasterin e drejtorisë së Arsimit. Rastin e kemi në "Tre Dëshmorët" ka qenë e rrezikshme për fëmijë dhe punëkryesi e ka marrë një pjesë të tyre në përdorim për rregullimin e fushës së sportit. Njëjtë ka ndodhur edhe në gjimnaz. Jemi për me e ruajtur parandë publike.

Negjdet Ramaj- desha ta di tenderin kur te merr punëkryesi a e merr me çmim më të lartë për shkak se duhet me i vendosur të reja ato rrethoja, apo e merr më të ulët për shkak se i përpunon ato rrethoja. Kisha pas dëshirë me e pa atë tender.

Kryetari i Komunës- pyetjen mundesh me ja drejtuar zyrës së Prokurimit, me kërkesë për qasje në dokumente, e merr edhe çmimin edhe formën e procedurës edhe a ka qenë me renovim apo me asgjësim. Ka raste që renovohej ka që asgjësohet, varësisht prej vlerësimit që ja kanë bërë ekspertët.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- ne mandatin e kaluar e kemi pasur çështjen e objektit ku ka qenë hoteli ish Korenik dhe e kemi pas vendosur që me u rrënuar ajo dhe është objekt i vjetër dhe ajo pjesa me qenë aty pjesë e gjelbëruar. Atje disa përgjigje jo nuk është pronë komunale, kisha pasur dëshirë me ditë saktësisht pse nuk është rrënuar apo është interes i dikujt me qëndruar ende, si është puna.

Kryetari i Komunës- është e vërtetë që ka ekzistuar një vendim i asamblesë së kaluar, por mes asaj kohe dhe sot janë zhvilluar shumë procedura, një prej tyre ka qenë edhe Harta Zonale. Aty ka pronar privat edhe lokale edhe banesa, kanë dalur inspektorët e ndërtimit dhe ata sanitar dhe kanë konstatuar që objekti më nuk i plotëson kushtet as për banim e as për asgjë tjetër. Shpejt besoj që ka me filluar procedura e rrënimit në të njëjtën kohë kemi projektuar si komunë se prona është komunale një objekt që i përshtatet konfiguracionit të terrenit tani nëpërmjet së cilit e kemi mundësinë që me ja u kthyer njerëzve që i kanë pronat private pjesën me metrave katrorë dhe pjesa tjetër mbetet në pronësi të komunës. Pajtohem që sa më parë duhet të eliminohet prej aty për shkak të pamjes edhe të rrezikshmërisë që paraqet si objekt.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Agron Gashi.

Agron Gashi- i kam dy pyetje por drejtorët nuk qenkan këtu, drejtorin e Inspeksionit nuk e gjejmë asnjëherë këtu ndoshta kryetari ka ndonjë përgjigje pse kjo jo transparencë ndaj qytetarëve, dhe kam bërë pyetje shpesh për atë drejtorin, as nuk sjellë përgjigje as nuk vjen ne mbledhje.

Kryetari i Komunës- Agron, drejtorët secili e ka natyrën e vet të punës edhe një prej me të ndjeshmet është drejtoria e Inspeksionit. Me thënë në thonjëza është "polici i komunës" edhe te mbikëqyrja e ndërtimit edhe e lejeve edhe e dëmeve që bëhen në pjesën e lumit dhe nuk ka shqetësim që është ngritur qoftë prej shoqërisë civile qoftë prej Kuvendit të komunës së Istogut, apo qoftë prej grupeve të interesit. Tash tjetër është që aktivitetet që kërkojnë prezencën e tij. Puna e tij dallon prej krejt drejtorive të tjera dhe konsideroj që është në grupin e drejtorëve më të përgjegjshëm edhe me aktiv në kuptim të realizimit të detyrave të tij atë e them me bindje të plotë. Pjesa e tjetër e drejtorëve që kanë të bëjnë më shumë me publikun, sa i përket kërkesave dhe pyetjeve janë prezentë këtu. Mos të lëshohemi në konstatime.

Agron Gashi- pasi nuk është drejtorin po ja bëj pyetjen kryetarit. A është në dijeni kryetari që para dy javë është kthyer sërish ajo gjendja e lumit në Istog prej hedhjes së mbetjeve inerte dhe pastrimit të fabrikave. Dhe a është shqiptuar ndonjë gjobë.

Kryetari i Komunës – detyra apo kompetenca e inspektoriatit komunal, në rastet e ndotjes së lumit është në raportimin në inspektoriatin qendror, sepse operatorët ekonomik që operojnë përkrah lumit nuk licencohen prej ekzekutivit komunal. Është ligji që merret me mbrojtjen e ambientit dhe të ujërave që vjen në kuadër të ministrisë së Ambientit konkretisht inspektoriatit qendror të cilët menjëherë pas raportimit edhe në media edhe të qytetarëve edhe raporteve zyrtare që i kemi dorëzuar kanë dalë në terren dhe sigurisht që kanë shqiptuar gjoba. Ata nuk janë të obliguar që të na raportojnë neve për punën që e bëjnë, janë të obliguar në rast se ka ndonjë masë ndaluese na i dërgojnë informacionet e sakta që ne me i monitoruar se a po i respekton operatori masën ndaluese a jo, përndryshe është kompetencë direkte e ministrisë së Ambientit. Për më tutje, jemi në fazën e finalizimit të projektit që ka me e trajtuar komplet lumin e Istogut po e them kështu, prej nën Troftë e deri te fshati Zabllaq dhe që eliminon ndotjen prej që përfundon ai projekt e tutje. Është një prej projekteve më të mëdha që ka komuna e Istogut, nëse nuk gaboj kalon vlerën e 8 milion euro dhe në të njëjtën kohë ja u pamundëson operatorëve që munden me qenë të papërgjegjshëm kohë pas kohe e që me vazhduar me trendin e njëjtë. Licencimet e tyre merren prej ministrisë së Ambientit, ne nuk kemi kompetencë as me ndërhyrë e as me e mbikëqyrë realisht.

Agron Gashi- unë të parashtrova pyetje direkte kryetar, a e di a është iniciuar rast para dy javësh që ka ndodhur ajo? Për këtë arsye është mirë me qenë drejtori këtu se janë çështje teknike që ti mundesh mos me i ditë. Shtrimi i lumit e këto kanë punë tjera, ka mbetje inerte, vajra motorike dhe gjithçka tjetër, është shkatërruar lumi, ne e dimë që ka me u rregulluar lumi, por ajo pjesa e nër vadës e dinë shumë mirë, se të gjitha se ushqimi na vjen nga ai lum, dhe jemi duke marrë sëmundje prej atij lumi, nuk është duke u kontrolluar.

Kryetari i Komunës- Agron, tokat e familjes i kam te ajo pjesë dhe e di se çfarë ndodhë saktë, edhe se çfarë ka ndodhur në të kaluarën, ka njerëz mjaftushëm të pa përgjegjshëm që lumin e shfrytëzojnë si deponi. A është minimizuar me raste po, ne gishta të dorës siç thotë populli, dhe jo inspektoriatit komunal e as policia nuk mundet me e përcjellë atë hap pas hapi. Te pjesa a është ndërmarrë diçka, pikërisht kom me e obliguar drejtorin me ju drejtuar inspektoriatit qendror me pyet konkretisht për hapat që janë ndërmarrë në atë drejtim.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Lavdije Bujupaj.

Lavdije Bujupaj- e kam një pyetje për drejtorin e Arsimit pasi qenka ende këtu, sa ka mundësi drejtor që kontrollat në shkollën fillore “Bajram Curri” në Istog të rriten për siguri të nxënësve. Sa herë në muaj kontrollohen nxënësit se a mbajnë armë të ftohta që paraqesin problem permanent për fëmijët tonë në shkollë. Është shqetësim i prindërve.

Naïm Behlulaj- pyetje me vend, pyetje që na shqetëson të gjithëve, fatmirësisht drejtorja e shkollës në koordinim me kujdestarët e klasëve dhe mësimdhënësit, pothuajse çdo javë e bëjnë kontrollimin e çantave të nxënësve bashkë me kryetarin e

këshillit të nxënësve dhe kryetarin e klasës. Ne e kemi një marrëveshje edhe me policinë e Kosovës, që kemi filluar përveç jashtë shkollës kemi filluar edhe nëpër autobusë të bëjmë kontrolla. I falënderoj të gjithë akterët se po bëjnë një punë të mrekullueshme, a është e mjaftueshme jo, por gradualisht do ti rritim kontrollat edhe me shpesh.

Lavdiye Bujupaj- janë gjetur armë të ftohta, këshu që të keni parasysh që kontrollat të vazhdojnë. Faleminderit!

Naim Behlulaj- është e vërtetë se janë gjetur, por janë reduktuar shumë për shkak të kontrollave që po i bëjmë.

Kryesuesi i Kuvendit- Fjolla Ukaj e ka fjalën.

Fjolla Ukaj- desha të pyes a janë kryer punimet nga “Hidrodrini” në rrugën “Ahmet Rugova” janë ndërruar gypat, por çka ka mbetur keq pas këtij investimi është se ka mbetur rrugë e pa kalueshme dhe asfalti është prerë. Desha ta di kur do të intervenohet apo a do të bëhet shtrimi i kubëzave se atë pjesë po e frekuentojmë çdo ditë me fëmijë.

Abedin Kabashi- kompania “Hidrodrini” e ka shpallur një tender për fazën e dytë dhe ka kontraktuar një kompani, realisht ne si komunë nuk kemi asnjë përgjegjësi për atë projekt, momentin që ti e ke cekur atë pjesë edhe herën e kaluar kam kontaktuar me kompaninë edhe ai i ka marrë disa masa por jo të kënaqshme, sigurisht që edhe në ditët në vazhdim do të kontaktoj që ta bëj nivelizimin e kubëzave faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Ardita Idrizaj.

Ardita Idrizaj- e kam një kërkesë për drejtorin e Shërbimeve Publike a kishte pasur mundësi në fshatin Lubozhdë të rruga “Shala e Kodrës” me vendosur ndalesa sepse fëmijët realisht por janë shumë të rrezikuar kur po shkojnë në shkollë, e di që nuk është kompetencë e juaja, por a ka mundësi me e bërë një kërkesë në ministrinë përkatëse.

Abedin Kabashi- ne si komunë nuk e kemi asnjë mundësi të ndërhyjmë në rrugët regjionale, realisht edhe para dy vitesh me drejtorin e Arsimit e kemi bërë një kërkesë në ministrinë e Arsimit që me e bërë para shkollave atë pjesën me asfalt por nuk kemi marrë përgjigje pozitive. Tani sigurisht duhet me e adresuar rastin që e ceke të ministria e Transportit nëse ata e shohin të arsyeshme sigurisht që do të realizohet.

Kryesuesi i Kuvendit- e shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme.
Falënderon të gjithë për durimin që patën, dhe kontributin e dhënë,
E shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme.
Faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në mbledhjet e tjera.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:30

**Procesmbajtëse,
Flora Bujupaj**



**Kryesues i mbledhjes,
Enver Rugova**

